191/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 7745/1 Prot. Tiranë, më 30/12 2015

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës tuaj për informacion nr.191/15

Drejtuar: Zotit Dorian Matlija
Drejtor Ekzekutiv
Qendra Res Publica
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3,ap.44, kati 9

TIRANË

I nderuar z.Matlija,

Në përgjigje të shkresës suaj, protokolluar pranë nesh me nr.prot.7745, datë 09.12.2015 me anë të së cilës kërkoni informacion lidhur me (i) numrin e procedimeve disiplinore që Ministria e Drejtësisë ka iniciuar ndaj gjyqtarëve gjatë vitit 2015 në Këshillin e Lartë të Drejtësisë; (ii) sa nga këto procedime disiplinore janë marrë në shqyrtim nga KLD-ja; (iii) cilat janë shkeljet e kryera nga gjyqtarët dhe çfarë masash ka marrë KLD-ja për shkeljet e konstatuara, ju bëjmë me dije se:

1. Ministri i Drejtësisë gjatë vitit 2015 ka dërguar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë **16 kërkesa** për procedim disiplinor ndaj gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit, në mbështetje të nenit 34 të Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 31 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar

2. Nga 16 kërkesat e dërguara në KLD nga Ministri i Drejtësisë gjatë vitit 2015, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar vetëm 1 kërkesë për procedim disiplinor, për të cilën është kërkuar nga Ministri i Drejtësisë "Shkarkim nga detyra " i gjyqtarit, për shkelje shumë të rënda, parashikuar nga neni 32/2 i Ligjit nr.9877, datë 18.02.2008" Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ndërsa KLD ka vendosur masën disiplinore "*Vërejtje me paralajmërim*".

3. Shkeljet e kryera nga gjyqtarët për 16 kërkesat e dërguara në KLD janë:
(i) Në 14 raste për ***shkelje shumë të rënda***, nga të cilat në 13 raste është kërkuar "*Shkarkim nga detyra*" dhe në 1 rast është kërkuar "*Vërejtje me paralajmërim*";
(ii) në 2 raste për ***shkelje të rënda,*** nga të cilat në 1 rast është kërkuar "*Vërejtje me paralajmërim*", ndërsa në 1 rast është kërkuar "*Dërgimi për 1 deri në 2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ka emërimin e tij*".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

LLAMBRIOLA MISTO